



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 29.01.2019
Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8668, DATË 23.10.2000, “PËR PAJISJEN
E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË PËR JASHTË SHTETIT”, TË
NDRYSHUAR”

- ***Hyrje***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës shqyrtoi në mbledhjen e datës 28.01.2018 në parim, nën për nen dhe në tërësi, projektligjin “*Për një ndryshim në ligjin nr.8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar*”.

Për të prezantuar projektligjin në komision ishin të pranishëm Zonja Rovenë Voda Zv/Ministre në Ministrinë e Brendshme së bashku me stafin mbështetës.

Relator i projektligjit u caktua zonja Elena Xhina.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën, si dhe propozon një ndryshim në ligjin nr.8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar.

Gjithashtu, ndryshimi i propozuar është në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.8668, datë 23.10.2000, “Për paisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, i ndryshuar, propozohet në kuadër të lehtësimit të procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj shtetasve, me qëllim autorizimin e Ministrit të Brendshëm, për përcaktimin me udhëzim të procedurës për ripajisjen me pasaportë biometrike të zakonshme, si dhe të dokumentacionit që paraqitet nga shtetasit shqiptarë, që do të aplikojnë për t’u ripajisur me pasaportë biometrike.

Gjithashtu, në projektligj është parashikuar mundësia e ripajisjes me pasaportë edhe 6 (gjashtë) muaj para mbarimit të afatit të vlefshmërisë së pasaportës së mëparshme biometrike, në rastet kur shtetasi udhëton apo qëndron përkohësisht në shtete që kushtëzojnë hyrjen apo qëndrimin në territorin e tyre, me afatin 6-mujor të vlefshmërisë së pasaportës. Ky ndryshim bëhet për t’i dhënë mundësi shtetasve që, në kuadër të lëvizjes së lirë, të mos kushtëzohen nga politikat e shteteve të ndryshme, në lidhje me kriteret e hyrjes dhe të qëndrimit në territorin e këtyre shteteve, të lidhura me afatin e vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit/pasaportës, në veçanti, kur u duhet të udhëtojnë dhe të qëndrojnë në këto shtete, për motive studimi, kurimi apo arsye të tjera, të cilat diktojnë udhëtimin apo qëndrimin për një periudhë të caktuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ndryshimi i propozuar bëhet në kuadër të lehtësimit të shërbimeve dhe nuk cenon sigurinë e pasaportës biometrike, por eliminon paraqitjen pranë komisarivateve të policisë të të gjithë shtetasve, të cilët janë verifikuar një herë nga policia, kur kanë aplikuar për pasaportë biometrike për herë të parë.

Projektligji përbëhet nga 3 nene.

Në nenin 1 janë parashikuar rastet kur shtetasi ripajiset me pasaportë biometrike, në rastet e përcaktuara në nenin 9, të ligjit nr.8668/2000, të ndryshuar, kur pasaportës i ka mbaruar afati i vlefshmërisë dhe, përjashtimisht nga ky rregull shtetasi mund të ripajiset me pasaportë biometrike edhe para mbarimit të afatit të vlefshmërisë, kur pasaportës së mëparshme i kanë mbetur edhe 6 muaj nga afati i përcaktuar i vlefshmërisë. Ky ndryshim është propozuar duke pasur parasysh politikat e disa shteteve, të cilat kanë të përcaktuar në legjislacionin e tyre të brendshëm kushtin e vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit për shtetas që udhëtojnë dhe qëndrojnë përkohësisht në territorin e tyre.

Për analogji, një nga kriteret që shtetasit shqiptarë duhet të plotësojnë për të dalë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është se duhet të posedojnë pasaportë të vlefshme, e cila, për të hyrë në zonën *Schengen* duhet të ketë minimumi 3 (tre) muaj afat vlefshmërie, ndërsa për të hyrë në shtete të tjera, jashtë zonës *Schengen*, duhet të ketë minimumi 6 (gjashtë) muaj afat vlefshmërie.

Konkretisht, në ligjin nr.108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, është parashikuar në nenin 6, të tij, si kusht për hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë, për shtetasit e huaj, vlefshmëria e pasaportës/dokumentit të udhëtimit të njohur nga Republika e Shqipërisë. Dokumenti i udhëtimit duhet të ketë një afat vlefshmërie të paktën 3 muaj para datës së përfundimit të tij.

Procedura për ripajisjen me pasaportë biometrike të zakonshme, dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqitet, si dhe dokumentacioni provues apo deklarata që duhet të plotësojë shtetasi, për shtetin drejt së cilit do të udhëtojë apo qëndrojë, kur do të ripajiset me pasaportë 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të afatit të vlefshmërisë, do të përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.

Në nenin 2 është përcaktuar dispozita e delegimit të nxjerrjes së udhëzimit të ministrit të Brendshëm, ku do të përcaktohet procedura e ripajisjes së shtetasve shqiptarë me pasaportë biometrike të zakonshme dhe dokumentacioni përkatës.

Në nenin 3 është përcaktuar hyrja në fuqi e projektligjit.

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën, si dhe propozon një ndryshim në ligjin nr.8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar.

Gjithashtu, ndryshimi i propozuar është në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

- ***Diskutimi në komision***

Gjatë prezantimit të projektligjit Zv/Ministrja e Ministrisë së Brendshme, zonja Rovenë Voda, u shpreh se projektligji vjen në kuadër të lehtësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Nëvoja për ndryshim në ligj lind për shkak të fluksit shumë të madh që do të kemi për ripajisjen me pasaportë biometrike pasi në fund të vitit 2019 mbushet dhe afati 10 vjeçar i

vlefshmërisë së pasaportave si dhe, duke qënë se jemi në prag të zgjedhjeve lokale, për t'ju dhënë mundësi qytetarëve të cilëve ju skadon pasaporta, të ushtrojnë një të drejtë themelore kushtetuese, sic është e drejta e votës.

Mandej zonja Voda, u shpreh se ligji aktual ka qënë i kufizuar pasi i referohej vetëm rastit të pajisjes me pasaportë biometrike, ndërsa në rastin e ripajisjes përcaktohet vetëm se “për ripajisjen zbatohen të njëjtat rregulla si për pajisjen me pasaportë”. Me këtë ndryshim krijojmë mundësi të përcaktohen qartë rastet kur shtetasi ka të drejtën të ndjek procedurën për ripajisjen me pasaportë biometrike dhe të gjitha kriteret që do të jenë shumë lehtësuese për qytetarët të cilat do të përcaktohen me udhëzimin e Ministrit të Brendshëm.

Gjithashtu, zonja Voda tha se ndryshimi ka ardhur edhe si një shqetësim për shkak të kontroleve që bëhen në kufi në rastet e vlefshmërisë së pasaportes në ato shtete që përcaktojnë një afat maksimal deri në 6 muaj (si psh. Turqia dhe SHBA), pra 6 muaj para sipas këtyre shteteve pasaporta konsiderohet e skaduar dhe shtetasit shqiptarë nuk mund udhëtojnë jashtë shtetit.

Më pas fjalën e mori relatorja e projektligjit, zonja Elena Xhina, e cila e vlersoi nismën si një risi dhe që do të sjell mjaft lehtësim për qytetarët të cilët udhëtojnë jashtë vendit.

Gjatë diskutimeve në komision anëtarët e vlerësuan nismën si dhe ngritën disa çështje për diskutim siç ishte edhe zgjatja e afatit për t'u ripajisur me pasaportë nga 6 muaj në 1 vit. Zonja Voda u shpreh se afati 6 muaj është afati maksimal që kanë disa shtete si psh. Turqia dhe SHBA, pra 6 muaj para sipas këtyre shteteve pasaporta konsiderohet e skaduar dhe shtetasit shqiptarë nuk mund udhëtojnë jashtë shtetit, ndërsa për vendet e BE-së ky afat është 3 muaj.

Gjithashtu u diskutua edhe për vlefshmërinë e 1.4 milionë kartave të identitetit të cilat skadojnë në muajin mars. Anëtarët e komisionit i kërkuan zonjës Voda nëse ky afat mund të shtyhej pasi fluksi për ripajisjen është tepër i madh dhe se jemi në prag të zgjedhjeve lokale.

Zonja Voda u shpreh se ministria ka marrë të gjitha masat e nevojshme për ripajisjen me karta identiteti të atyre personave të cilët ju skadon, por ky ndryshim nuk mund të bëhet me ligjin nr.8668, datë 23.10.2000, “Për paisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, i ndryshuar, por me ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002 “Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar, ndryshim ky i cili do vi shumë shpejt.

• **Përfundim**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

- *Në aspektin ligjor*, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- *Në aspektin procedural*, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Relator

Elena XHINA

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ